



# GSRM

## KOMISIONE TË APLIKUARA NGA NDËRMJETËSIT FINANCIAR

**Material Infomues**

**INFORMACIONI MBI KOMISIONET PËR VEPRIMET E BONOVE TË THESARIT QË APLIKOHEN NGA RAIFFEISEN BANK ALBANIA**

1. Nëse një klient blen një Bono Thesari në tregun primar pranë bankës Raiffeisen (nëpërmjet pjesëmarrjes në ankand) komisioni që aplikohet për individët është 0.6% e shumës së investuar kurse për klientë jo individ, komisioni që aplikohet është 0.2% e shumës ( komisioni minimal është 2,000 lekë, ndërsa komisioni maksimal është 5,000 lekë)

2. Për shitjen e Bonove të Thesarit nga Portofoli i bankës në tregun sekondar, nuk aplikohet asnjë komision. Në këtë rast klientit do ti llogaritet çmimi i shitjes së bonos së thesarit në bazë të yieldit të shitjes për ditët e mbetura deri në maturim.

**Shembull:**

Nëse një klient dëshiron të investojë pranë bankës Raiffeisen një shumë 1,500,000 lekë në një Bono Thesari 6 mujore, të cilës i kanë mbetur 132 ditë deri në maturim, duke pasur parasysh që yield-i në shitje është 6.00%, çmimi i shitjes llogaritet si më poshtë:

$$\text{Çmimi i shitjes} = 1,500,000 * C / 6.00 + C$$

Ku C-ja është një konstante e cila llogaritet  $365 * 100 / 132$

$$\text{Çmimi} = 1,500,000 * 276.52 / 6.00 + 276.52 = 1,468,143 \text{ lekë}$$

3. Në rastin kur klienti dëshiron të shesë një Bono e Thesari, pranë bankës Raiffeisen, para datës së maturimit (banka bën blerjen e të gjithë bonove me më shumë se 7 ditë të mbetura deri në maturim), ne nuk aplikojmë asnjë komision.

Në këtë rast, çmimi i blerjes së Bonos së Thesarit do të llogaritet në bazë të yield-it të blerjes dhe ditëve të mbetura deri në maturim.

**Shembull:**

Nëse një klient do të shesë para afatit të maturimit një Bono Thesari 12 mujore, me 250 ditë të mbetura deri në maturim, me vlerë nominale 1,000,000 lekë, nëse yield-i në blerje që ne aplikojmë është 8.00%, atëherë çmimi llogaritet si më poshtë:

$$\text{Çmimi i blerjes} = 1,000,000 * C / 8.00 + C$$

Ku C-ja është një konstante e cila llogaritet  $365 * 100 / 250$

$$\text{Çmimi} = 1,000,000 * 146 / 8.00 + 146 = 948,052 \text{ lekë}$$